



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI**

VENDIM

Nr. 133, datë 30.09.2020

**PËR
MIRATIMIN E RREGULLORES “MBI KOMUNIKIMIN ME INVESTITORËT”**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 2, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar dhe të neneve 16, 86, 87, 90, 92, 93, 97, 98, 99, 100, 109, 121-129, Seksoni 2 dhe 3 të Kreut VI, Kreut IX, neneve 155-157 dhe pikës 5 të nenit 195 të Ligjit nr. 56/2020 “Për sipërmarrjet e investimeve kolektive”, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I :

- 1. Miratimin e rregullores “Mbi komunikimin me investitorët”, sipas materialit bashkëlidhur.**
- 2. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes së Tregut të Kapitaleve dhe Fondeve, për njoftimin dhe ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.**

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**ANËTAR
Deniz DERALLA**

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV
Ervin METE**